

Korrik 2015
Prishtinë, Kosovë



Inicuar dhe mbështetur nga
Fondacioni i Kosoves për Shoqëri të Hapur

Projekti: Shoqëria civile dhe procesi i
integritimit evropian të Kosoves



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Progresi në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore

Input për Raportin e Shtetit 2015

Progresi në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore

Korrik 2015
Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

5	Parathenie
7	Progresi në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore
9	Sfidat kryesore
11	Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
13	Sistemi i drejtësisë në raport me ndërtimet pa leje dhe dëmtimin e trashëgimisë
16	Mekanizmat menaxhues jo-efikase në Qendrën Historike të Prizrenit
18	Intervenimet jo adekuate rrezikojnë vlerat e trashëgimisë kulturore
20	Mbrojtja e qendrave historike të qyteteve tjera

Shkurtesat

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

KTk – Këshilli për Trashëgimi Kulturore (i Prizrenit)

KK – Kuvendi i Komunës

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

KKTK – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

QHPz – Qendra Historike e Prizrenit

TF – Task Force (për Qendrën Historike të Prizrenit)

OJQ – Organizatë Jo-qeveritare

IAK – Instituti Arkeologjik i Kosovës

TK – Trashëgimi Kulturore

Parathenie

Transformimi i një shteti me synim anëtarësimi në Bashkimin Evropian nuk mund të ngjajë pa pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Përpos konsultimit të rregullt në çështje të politikave zhvillimore, mbështetja me e mire e organizatave të tilla vjen kur ato monitorojnë me shumë vëmendje progresin e qeverisë në këtë rrugë transformuese. Është mu ky segment të cilin Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur e mbështet që nga viti 2006 përmes programit për Integrim Evropian.

Në vitin 2014 kjo mbështetje arriti kulmin kur një numër i organizatave Kosovare think tank me përvojë shumëvjeçare të monitorimit dhe analizimit të politikave të caktuara qeveritare prodhuan raporte monitorimi në tema të fokusuara. Të organizuara në edicione të veçanta, këto raporte u bënë publike në konsultimin plenar mes Komisionit Evropian dhe organizatave të shoqërisë civile me 24 qershor, 2014.

Duke ndërtuar në këtë përvojë të suksesshme, Fondacioni ka mbështetur një numër të organizatave të vazhdojnë angazhimin e tyre përmes zhvillimit dhe adoptimit të indikatorëve dhe nën-indikatorëve matës vetanak në çështje specifike të politikës evropianizuese. Secila çështje e monitoruar ka dalur nga Raporti i Progresit 2014, dhe është e ndërtuar në ekspertizën e dëshmuar të organizatës. Kështu, monitorimi disamujor ka rezultuar me të gjetura dhe rekomandime interesante si për Qeverinë e Kosovës ashtu edhe për Bashkimin Evropian. Raportet do të bëhen publike gjatë Konsultimit Plenar me Shoqërinë Civile të Dialogut Procesit të Stabilizim Asociimit në korrik 2015.

Në këtë menyrë, Fondacioni beson se potenciali i shoqërisë civile do t'i shërbejë më së miri ecjes përpara në rrugëtimin transformues pro-evropian. Ashtu siç ky synim mbetet të arrihet në të ardhmen, në të njëjtën mënyrë angazhimi i shoqërisë civile bëhet me i rëndësishëm dhe i nevojshëm për t'u siguruar se një spektër i gjerë i politikave po ecin para, dhe kjo ecje është e matshme dhe sjelle ndryshime në jetën e qytetarëve Kosovarë.

Iliriana Kaçaniku

Programi për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë

Progresi në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore

Sfidat kryesore

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Rastet e dokumentuara përgjatë vitesh të degradimit në Zonat e Veçanta të Mbrojtura, veçanërisht në Qendrën Historike të Prizrenit, së fundmi dëshmohen edhe nga të dhënat statistikore të marra nga institucionet përgjegjëse, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë (apo nuk ofrojnë për publikun) të dhëna të strukturuar, ndërkohë që vija ndarëse për rastet në Qendrën Historike nuk ekziston për gjyqësorin.

Sistemi i drejtësisë në raport me ndërtimet pa leje dhe dëmtimin e trashëgimisë

Rastet e raportuara të ndërtimeve pa leje në institucionet gjyqësore të Prizrenit, që ka një ligj të veçantë për Qendrën Historike mund të numërohen në gishta, sikurse edhe ato që janë në hetime nga Prokuroria.

Mekanizmat menaxhues jo-efikase në Qendrën Historike të Prizrenit

Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit, pas takimit inaugurues në muajin mars ka mbajtur edhe dy takime pune brenda vitit 2015. Deri më tani asnjë rast nuk është shqyrtuar nga Task Forca, dhe deri më tani nuk ka vendime të nxjerra nga për trajtimin e ndërtimeve pa leje në QHPz.

Intervenimet jo adekuate rrezikojnë vlerat e trashëgimisë kulturore

Nisja e projekteve/punimeve pa i përmbushur procedurat e duhura ligjore dhe pa u pajisë me pëlqimet lejet përkatëse ndërtimore të autoriteteteve publike po shndërrohet në praktikë nga organet komunale, njëjtë sikurse edhe mosrealizimi i debateve të mirëfillta me komunitetin për projektet konservuese apo investime në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore

Mbrojtja e qendrave historike të qyteteve tjera

Institucionet përgjegjëse janë treguar të zbehta edhe sa i përket ndërmarrjes së veprimeve për dokumentimin e gjendjes në qendrat historike të qyteteve tjera si dhe të veprimeve rehabilituese, në mënyrë që të shtohen masat mbrojtëse.

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Institucionet që kanë detyrime të qarta ligjore për të vepruar për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike, prej vitesh kanë vendosur që t'i mbyllin sytë dhe veshët kundruall degradimeve në këtë fushë dhe në mënyrë të heshtur kanë instaluar kulturën e pandëshkueshmërisë.

Tashmë është theksuar shumë herë se Kosova ka kornizë legjislative dhe institucionale të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe se realizimi i obligimeve ligjore që dalin nga këto dokumente janë përgjegjësi e një numri të madh institucioneve qendrore dhe lokale, përfshi ministritë e linjës, komunat, gjyqësorin dhe policinë. Dhe këto përgjegjësi janë të definuara në mënyrë qartë dhe nuk lënë hapësirë për interpretime ose keqkuptime. Me gjithë këtë kornizë legjislative dhe institucionale ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mbetet një sfidë për Kosovën.

Rastet e dokumentuara përgjatë vitesh të degradimit në Zonat e Veçanta të Mbrojtura, veçanërisht në Qendrën Historike të Prizrenit, së fundmi dëshmojnë edhe nga të dhënat statistikore të marra nga institucionet përgjegjëse, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë (apo nuk ofrojnë për publikun) të dhëna të strukturuar, ndërkohë që vija ndarëse për rastet në Qendrën Historike nuk ekziston për gjyqësorin.

Kjo kulturë e pandëshkueshmërisë ka bërë që institucionet të injorojnë edhe llogaridhënien dhe transparencën përballë publikut, sa i përket ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Madje ka raste të numërta kur investimet publike të kontraktuara nga institucionet qoftë lokale apo qendrore kanë rezultuar me dëmtim apo tjetërsim të vlerave të dikurshme kulturore, ndërkohë që nuk ka pas sanksione ligjore për këto lëshime.

Janë evidentuar raste kur niveli lokal, si në rastin e Komunës së Prizrenit, i injoron detyrimet ligjore dhe realizon punime pa u pajisur me pëlqime nga MKRS-ja dhe KTK-ja e Qendrës Historike të Prizrenit.

Kosova ndonëse ka një zinxhir institucional që duhet të përkujdeset për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, megjithatë në këtë situatë del në pah fakti se hallkat e saja nuk janë të lidhura dhe nuk funksionojnë ashtu siç përkufizojnë dispozitat ligjore. Mungesa e koordinimit në pushtetet e nivelit lokal me atë qendror, sa i përket

planifikimit hapësinor e urban dhe trashëgimisë kulturore tashmë është evidente dhe pranohet nga vet zyrtarët, derisa pushteti gjyqësor nuk trajton në mënyrë të duhur veprat penale që kanë të bëjnë me dëmtimin dhe shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore kërkon edhe inspektim të rregullt, që në bazë të ligjeve në fuqi duhet të kryhet nga niveli komunal dhe MKRS-ja, me ç'rast kjo e fundit nuk ka inspektorë por angazhon zyrtarët e QRTK-ve që të hartojnë raporte të vlerësimit. Ndërkohë niveli lokal është treguar neglizhent, gjë që shpesh e arsyeton me mungesë kapacitetesh njerëzore, që rezulton me mos ndërmarrje të masave parandaluese për dëmtimet në Zonat historike.

Madje institucionet përgjegjëse ende nuk kanë arritur që të ndërtojnë as një sistem vlerësimi për të matur zbatimin e letër udhëzuesit për planifikimin e politikave për Konservimin e Integruar në Kosovë.

Sistemi i drejtësisë në raport me ndërtimet pa leje dhe dëmtimin e trashëgimisë

Vitin e kaluar është theksuar se shkeljet e shpeshta të ligjeve në gjithë Kosovës në vazhdimësi po e dëmtojnë seriozisht trashëgiminë kulturore, dhe se zbatimi i kornizës ligjore që trajton trashëgiminë kulturore mbetet i dobët, derisa ndërtimet pa leje janë shqetësim i madh, sidomos brenda zonave të veçanta të mbrojtura. Veprimet ndëshkuese kundër shkelësve të ligjeve edhe pse duhet të aplikohet në mënyrë konsistente, një gjë e tillë ende nuk po ndodh, ndërkohë që shkeljet po vazhdojnë në Qendrën Historike. Rastet e raportuara të ndërtimeve pa leje në institucionet gjyqësore të Prizrenit, që ka një ligj të veçantë për Qendrën Historike mund të numërohen në gishta, sikurse edhe ato që janë në hetime nga Prokuroria.

Në bazë të dhënave të Gjykatës Themelore të Prizrenit janë evidentuar 6 lëndë në procedurë që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje. Një lëndë është në kompetencë të departamentit të përgjithshëm dhe pesë lëndë janë në kompetencën e divizionit për kundërvajtje. Ky institucion nuk ka mundur të ofroj sqarime nëse këto lëndë kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit ose dëmtimet e Trashëgimisë Kulturore.

Për dallim prej Gjykatës, Prokuroria Themelore e Prizrenit mban evidencë në mënyrë më të organizuar. Sipas kësaj Prokurorie 4 kallëzime penale ndaj 11 personave janë bartur nga vitet paraprake. Ndërsa të pranuar në punë në 3 muajt e parë 2015, 1 kallëzim ndaj 1 personi. Pra, gjithsej në punë në 2015-n, janë 5 kallëzime ndaj 12 personave, lidhur me shkeljet urbanistike në Qendrën Historike të Prizrenit. Ndërkohë kanë filluar hetimet në 2 kallëzime ndaj 9 personave dhe është ngritur një aktakuzë në 1 kallëzim ndaj 8 personave. Kanë ngelë në punë 4 kallëzime ndaj 4 personave.

Rekomandimi

Institucionet e drejtësisë (Gjykata Themelore, Prokuroria Themelore) duhet të shtojnë përpjekjet dhe përkushtimin për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve që kanë të bëjnë me dëmtimin e Trashëgimisë Kulturore, duke i kushtuar rëndësi këtyre rasteve në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kodin penal të Kosovës. Zbatimi i Kodit penal është esencial për vënien e rregullit në fushën e Trashëgimisë Kulturore.



Mekanizmat menaxhues jo-efikase në Qendrën Historike të Prizrenit

Task Forca për qendrën historike të Prizrenit e krijuar më 13 mars 2014, që përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Kulturës, asaj të Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komunës së Prizrenit dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturorë, ka për qëllim zbatimin e ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Ligjit Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit. Në vitin e parë të ekzistimit të saj, kjo Task Forcë nuk është mbledhur asnjëherë.

Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit, pas takimit inaugurues në muajin mars ka mbajtur edhe dy takime pune brenda vitit 2015. Deri më tani asnjë rast nuk është shqyrtuar nga Task Forca, dhe deri më tani nuk ka vendime të nxjerra nga për trajtimin e ndërtimeve pa leje në QHPz.

TF ka marrë vendim të bëhet grumbullimi i dokumenteve/rasteve për ndërtimet pa leje, tejkallimet apo shkeljet tjera të kriterëve urbanistike dhe të bëhet identifikimi i rasteve të ndërtimeve pa leje dhe tejkallimeve. Analiza e lëndëve duhet të kryhet deri në muajin shtator 2015, sipas dakordimit të anëtarëve të TF.

Është formuar sekretariati i Task Forcës (në përbërje të cilit janë tre zyrtarë të Komunës së Prizrenit, nga Urbanizmi, Inspektorati dhe Zyra Ligjore).

Ndërtimi i kapaciteteve financiare, administrative dhe njerëzore të Këshillit të Trashëgimisë Kulturorë të Qendrës Historike të Prizrenit vazhdon të jetë çështje problematike dhe Komuna e Prizrenit nuk ka ofruar përkrahje në këtë drejtim deri më tani.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka marrë vendim për themelimin e Zyrës së Qendrës Historike qysh në shkurt të vitit 2013, mirëpo e njëjta zyre ende nuk është funksionalizuar, ndërkohë që as që ka nisur që të ushtroj rolin që ka për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit. Për më shumë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim mbi informimin e publikut mbi rëndësinë dhe statusin e Qendrës së Mbrojtur Historike të Prizrenit.

Në anën tjetër Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka kërkuar raport nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe ka diskutuar për degradimin e QHPz në seancë plenare (për ndërtimin e bibliotekës pranë Ryzhdijes, Hamamin e Prizrenit, gjurmimet arkeologjike në shesh, Kalanë e Prizrenit dhe Sheshin e Lidhjes). Në Kuvendin e Kosovës, në formë të pyetjeve parlamentare janë ngritur çështjet e restaurimit të Hamamit të Gazi Mehmed Pashës, Kalasë së Prizrenit dhe investimeve publike pranë Ryzhdijes, me ç'rast ministri i Kulturës ka konfirmuar se punimet afër këtij monumenti të mbrojtur zhvillohen pa pëlqimin e MKRS-së, respektivisht në mënyrë të jashtëligjshme¹.

Rekomandimet

- Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit duhet të jetë më dinamike në punën e saj, ngase çdo vonesë reflektohet në terren me degradimin e mëtejshëm të Qendrës Historike të Prizrenit. Duhet të angazhoj më shumë profesionistë për analizën e mirëfilltë të lëndëve
- Anëtarët e TF duhet të tregojnë përkushtim të lartë për të zbatuar obligimet që kanë marrë
- MMPH duhet të siguroj se Task Forca do të përmbush mandatin që i është përshkruar
- Task Forca, MMPH dhe Komuna e Prizrenit duhet të jenë më transparente lidhur me procesin e vendimmarrjes për Qendrën Historike të Prizrenit
- Komuna e Prizrenit duhet të funksionalizoj në afatin sa më të shkurtër kohor zyra për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe të ofrohet mbështetja e duhur që kjo Zyrë të nis të ushtroj rolin që ka për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit
- KTK duhet të ketë mbështetje më të fuqishme financiare, administrative dhe njerëzore që të luaj rolin që ia ka përcaktuar ligji
- Komisioni Evropian të përfshihet më aktivisht në dialogun për domosdoshmërinë e fuqizimit të mekanizmave të krijuar për mbrojtjen dhe promovimin e TK.

1 <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Shala-Punet-per-Ndertimin-e-Bibliotekes-se-Prizrenit-Jane-te-Jashteligjshme-6480>

Intervenimet jo adekuate rrezikojnë vlerat e trashëgimisë kulturore

Intervenimet jo adekuate rrezikojnë vlerat e TK-së, dhe shembuj të tillë konkret janë paraqitur gjatë këtij viti në Kalanë e Prizrenit, që është njëri prej monumenteve më të rëndësishme arkeologjike në Kosovë. Një pjesë e murit ballor të Kalasë është rrënuar ngase gjatë punimeve konservuese-restauruese aty është përdor material i dobët dhe nuk është aplikuar mbikëqyrja e duhur e punimeve.

MKRS ka konfirmuar se kjo pjesë e murit është shembur si pasojë e depërtimit të lagështisë në brendi të strukturës së murit, por edhe si rezultat i materialit të dobët lidhës, që sipas zyrtarëve nuk ka qenë i cilësisë së lartë. Në të njëjtën kohë sipas tyre ka munguar mbikëqyrja e vazhdueshme e punëve restauruese-konservuese².

MKRS gjithashtu ka theksuar se punimet në restaurimin e pullazit të Hamamit janë ndërprerë për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Përderisa priten mjetet për vazhdimin e restaurimit, është raportuar se muajin e kaluar Hamami në dy raste ka qenë cak i keqbërësve, të cilët dyshohen se kanë dëmtuar shtresën e plumbit të vendosur në pullaz, gjë që është konfirmuar edhe nga Policia e Kosovës. Pra mos përmbyllja e punimeve në objektin e Hamamit e bën atë të cënueshëm³. Ndërkohë gjatë këtij viti ka pasuar edhe një valë e re e reagueve në lidhje me punimet e realizuara në Hamam, pa informimin dhe njoftimin e publikut për intervenimet e bëra.

Nisja e projekteve/punimeve pa i përmbushur procedurat e duhura ligjore dhe pa u pajisë me pëlqimet lejet përkatëse ndërtimore të autoriteteteve publike po shndërrohet në praktikë nga organet komunale, njëjtë sikurse edhe mosrealizimi i debateve të mirëfillta me komunitetin për projektet konservuese apo investime në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore⁴.

Ndërsa gjatë punimeve në një shesh të Prizrenit, është zbuluar një monument arkeologjik, me ç'rast IAK ka bërë germime fillestare, dhe prej muajsh ky vend mbetet pa trajtim, ngase asnjëri prej institucioneve as komuna e as MKRS nuk kanë ndarë

2 http://online-transparency.org/repository/docs/UW_Komunikate_23.doc.pdf

3 http://online-transparency.org/repository/docs/UW_Komunikate_19.pdf

4 http://online-transparency.org/repository/docs/UW_Komunikate_20.pdf

mjete për punimet e mëtejme konservuese të këtij sajti.

Rekomandimet

- Të gjitha institucionet e përfshira në projektet restauruese-konservuese duhet të sigurojnë që punimet të realizohen në mënyrë profesionale e transparente, me material dhe ekzekutim adekuat, në mënyrë që të ruhen dhe promovohen vlerat e monumenteve.
- Të gjitha institucionet e përfshira në projektet restauruese-konservuese të jenë të kujdesshme në planifikime dhe të përfshijnë shoqërinë civile dhe komunitetin në diskutime publike.
- Reagime adekuate me rastin e zbulimit të zonave arkeologjike

Mbrojtja e qendrave historike të qyteteve tjera

Institucionet përgjegjëse janë treguar të zbehta edhe sa i përket ndërmarrjes së veprimeve për dokumentimin e gjendjes në qendrat historike të qyteteve tjera si dhe të veprimeve rehabilituese, në mënyrë që të shtohen masat mbrojtëse.

Takimet e Komisionit të MKRS për Qendrën Historike të Prishtinës kanë vazhduar. Deri më tani janë mbajtur katër takime për hartimin e programit për Ruajtjen, Konservimin dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prishtinës. Është diskutuar për anën procedurale juridike dhe studimore rreth përcaktimit të Qendrës Historike të Prishtinës, dhe zhvillimeve të mëtutjeshme rreth Konservimit të Qendrës Historike të Prishtinës. Mirëpo ende nuk ka vendim për shpalljen e zonës së mbrojtur në Prishtinë.

Në grup punues për hartimin e Programit për Ruajtjen, Konservimin dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prishtinës dhe paraprkishtë përcaktimin e kufijve sipas MKRS-së janë të përfshirë përfaqësues nga: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Komuna e Prishtinës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, OJQ - Cultural Heritage without Borders, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor Prishtinë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Universiteti i Prishtinës, dhe përfaqësues të komunitetit.


Me vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës nr. 035-181427, datës 24.09.2013, është i përcaktuar qyteti i Vjetër. Sipas MKRS-së se çka saktësisht është e definuar me këtë plan, dhe për veprimet tjera që duhet të ndërmerren do të diskutohet në takim me përfaqësues të Komunës së Prishtinës.

Diskutime dhe vendim të KK Prishtinë për miratimin e planit të konservimit dhe zhvillimit në 2015 nuk ka pas. MKRS, MMPH, KKTK dhe komunat nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret për vlerësimin e gjendjes në qendrat tjera historike.

As për definimin e kufijve dhe shpalljen në mbrojtje të qendrave tjera historike nga ato ekzistuese nuk ka vendime të institucioneve, derisa ende nuk ka filluar hartimi i planeve të konservimit dhe zhvillimit për qendrat historike.

Rekomandimet

- Të bëhet definimi i kufijve, statusi ligjor dhe plani i konservimit dhe zhvillimit të QH Prishtinë në afatin më të shpejtë të mundshëm kohor nga institucionet përgjegjëse
- Të bëhet skenimi dhe vlerësimi i gjendjes së QH të Prishtinës
- MKRS, MMPH, KKTK dhe komunat të ndërmarrin veprime konkrete për vlerësimin e gjendjes në qendrat tjera historike
- Të nis hartimi i planeve të konservimit dhe zhvillimit për qendrat historike
- Komunat të ndërmarrin veprime për parandalimin dhe eliminimin e ndërtimeve pa leje në zonat historike
- Komisioni Evropian të ofroj ekspertizë për procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve të konservimit dhe zhvillimit për qendrat historike



Copyright © EC Ma Ndryshe.

Ky studim u hartua nga EC Ma Ndryshe, me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Për më shumë informata:
www.ecmandryshe.org
www.kfos.org